



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 10.12. 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati dhe Naim Rrustemi - anëtarë.

Mungoi: Vezira Emrush – anëtare.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Mërgim Bektashi dhe Hajdin Xhahaj nga Divizioni i Sigurimit Policor të Kosovës.

Mbledhjen e monitoruan: përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësuesi i KDI-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor.

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Shqyrtimi i disa peticioneve,
- 3 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i disa peticioneve

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi se Komisioni ka vendosur t'i ftojë Mërgim Bekteshin dhe Hajdin Xhahajn – punëtorë të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës, me qëllim që për së afërmi të informohet për shqetësimet e tyre. Kërkoj ta merrte fjalën raportuesja dhe të njoftohej Komisioni për përmbajtjen e peticionit.

Prof dr. Nerxhivane Dauti – E njoftoi Komisionin shkurtimisht dhe shtoi se peticioni është nënshkruar nga 201 pjesëtarë të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës, me të cilin kërkohet zbatimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 04/30 i 19. 08. 2008.

Vendimi i lartpërmendur e ka ndryshuar statusin e oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në zyrtarë policorë dhe ka bërë që mjetet financiare që do t'i destinohen Ministrisë së Punëve të Brendshme të merren nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Në peticion ceket se deri tani këtyre u janë mohuar përvoja e punës dhe aftësimet e fituara gjatë trajnimeve profesionale. Po ashtu thuhet se çdo aftësim profesional është i mirëpritur.

Si shqetësime cekën mohimi për disa i gradës së rreshterit dhe i përvojës duke kërkuar nivelizimin e pagave me njësitë e tjera policore.

Mërgim Bekteshi - E falënderoi Komisionin që ia ka mundësuar të jetë i pranishme në mbledhje për t'i paraqitur shqetësimet e cekura në peticion dhe që ato të zgjidhen në përputhje me ligjin. Ne i kemi plotësuar edhe me gojë, edhe me shkrim të gjitha kriteret e parapara me konkurs. Njëherësh e kemi plotësuar edhe testin psiko-fizik. Në bazë të kësaj është krijuar divizioni për sigurimin e objekteve institucionale, si: Presidencën, Kuvendin, Qeverinë dhe ministritë e saj. Pra, e kemi respektuar hierarkinë komanduese të SHPK-së dhe kemi krijuar kulturë të sjelljes ndaj deputetëve dhe personave të autorizuar shtetërorë. Qeveria e Kosovës, në bazë të vendimit nr. 04/30 të 19. 08. 2008, e ka ndryshuar statusin e oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në zyrtarë policorë. Për këtë jemi mirënjohës. Gjithashtu mjetet financiare për vitin 2008 do të sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, kurse për vitin 2009 do të planifikohen me procedurë të rregullt buxhetore.

Ministria do të kujdeset për zbatimin e vendimit që nga hyrja e tij në fuqi. Në fund shtoi se me Ligjin e Policisë së Kosovës nuk përfshihen gradat tona, edhe pse kemi bërë vërejtje për ndryshimin e statusit të oficerëve të sigurimit. Për këtë i kemi njoftuar organet e Shërbimit Policor, por nuk janë përgjigjur. Në fund u kërkua të zbatohet vendimi i Qeverisë së Kosovës, sepse konsiderohet se ata janë aftësuar profesionalisht për ushtrimin e detyrave të policisë.

Nerxhivane Dauti - Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit ua kujtoi atyre se në legjislaturën e parë ka pasur raste të ngjashme dhe kemi nxjerrë rekomandime përkatëse. Ishte e mendimit se po të respektohet parimi: keni fakte, keni edhe të drejtë, ka prova të mjaftueshme.

Ibrahim Makolli - Ceku se ka pasur lëshime në këtë fushë dhe kërkoj të shikohen aktet normative, ngase ishte një memorandum që e ka rregulluar këtë çështje. Për këtë kërkoj të shikohet legjislacioni se a ka pasur ndryshime pas vendimit të lartpërmendur. Duke u ndërlidhur me punën e njësitit theksoi se puna e tij gjatë dy vjetëve të fundit

është gjysmë legale. I rekomandoi Komisionit që ta ftojë Ministrin e Punëve të Brendshme dhe pasi ta dëgjojë, te nxirren konkluzionet. Arsyetimin që e mbështeti me fakte e përkrahën kryetari dhe të pranishmit.

Drita Maliqi – Parafolësit i shtroi pyetje që kanë të bëjnë me gradimet e zyrtarëve policorë.

Hajerdin Hyseni – Lidhur me petitionin theksoi se ka prova të mjaftueshme për zgjidhjen e tij. U pajtua që Komisioni ta mbajë një takim me ministrin e Punëve të Brendshme dhe pastaj të nxirren përfundimet.

Kryetari i rekomandoi Komisionit që në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit ta ftojë ministrin. Me këtë rast u nxor ky

Përfundim

- 1. Komisioni u pajtua që me ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të mbahet një takim, me qëllim që të informohet për së afërmi lidhur me shqetësimet e nënshkrueseve të petitionit.*
- 2. Anëtarët e Komisionit të njoftohen me kohë për mbajtjen e takimit.*

Mbledhja përfundoi në orën 13: 55.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri